



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. FLORJAN KALAJA



12/17/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, në datën 16.12.2020 për subjektin e rivlerësimit, Florjan Kalaja bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 17.12.2020, vendosi:

Konfirmimin në detyrë subjektit të rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Xhensila Pine, z. Olsi Komici relator, znj. Firdes Shuli anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.